



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Komisioni për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut;
Numër: 02/41;
Datë: 17.03.2015 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe nenit 8 paragrafi 8.6 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, **Komisioni për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij konstituive të mbajtur më 17.03.2015 nxjerrë:

V E N D I M

për

zgjedhjen e kryetarit të Komisionit për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut

I. Me këtë vendim zgjedhet z. **Nevruz KRASNIQI** kryetar i Komisionit për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut/në tekstin e mëtejme kryetari/.

II. Kryetari është i obliguar që ti kryesojë mbledhjet e Komisionit për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut në përputhje me nenin 9 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

III. Mandati i kryetarit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të tjerë të Komisionit për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut.

IV. Procedura e shkarkimit apo e zëvendësimit të kryetarit të komisionit është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të mbledhjes konstituive të komisionit.

Me këtë vendim njoftohen:

1. I zgjedhuri nga pika I. e këtij vendimi,
2. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut,dhe
3. Arkivi i Komunës së Junikut.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i seq	Data
2-006-2335	1	17-03-2015

Kryesuesi i mbledhjes konstituive



Faik TOFAJ

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>